

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Dilni jashtë"/ Eglja Ceno rrëfen debatin me Ramën në Berat: U irritua dhe ndërpreu dëgjuesën
ADRESA	https://albeu.com/lajme/dilni-jashte-egla-ceno-rrefen-debatin-me-ramen-ne-berat-u-irritua-dhe-nderpreu-degjesen/1009838/
BURIMI	albeu.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	13 shtator 2026, 14:43:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	13 shtator 2026, 14:40:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fc706178c5951782da5ca9017112ef133715af4c155f7d6140c5129f89d2798b
TEKSTI	6077c0c5d599e567d64fd416f70e9729754866a98e55e238f5a9d830dff05f3f
PAMJA	e3cd6426520f58bb0b0b71b8bbe73bc5e59bccd19c6a9069281940fcc01c3930

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	ab937db413e7fc9bb55d4839187f9dfcbd5a26200b985d1550bc4cb98a8b2d52
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	dfba2a1657f1a677e5566ccf3fa9a9b670157055fa0722c1f00364cf87701650
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ab937db413e7fc9bb55d4839187f9dfcbd5a26200b985d1550bc4cb98a8b2d52>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

“Dilni jashtë”/ Egla Ceno rrëfen debatin me Ramën në Berat: U irritua dhe ndërpreu dëgjuesën



Takimi i kryeministrit Edi Rama në Berat, ku po diskutohej ndarja territoriale, u përfshi nga përplasje të forta mes tij dhe një grupi përfaqësuesish nga Poliçani. Mes tyre ndodhej edhe aktorja Egla Ceno.

Në një prononcim për gazetarin e Top Channel, Bledar Korreshi, Ceno dha versionin e saj për zhvillimet në sallë. Ajo tha se kërkesa e saj ndaj kryeministrit kishte qenë vetëm që përfaqësuesit e Poliçanit të dëgjoheshin.

“Kishim ardhur si një grup përfaqësuesish të Poliçanit për të marrë pjesë në dëgjuesën për Territoriale. Ky qytet e ka shprehur disa herë qëndrimin e tij. Ministri Demo u dha mundësinë të flisnin qytetarëve, por fjalën e morën vetëm 2 prej tyre.

Më pas ndërhyri kryeministri dhe tha: ‘Ok, ok, se nuk jemi në një mbledhje për të dëgjuar sa mirë jetohej në Poliçan’. Pas kësaj nisi një fjalim me pyetje dhe përgjigje të dhëna prej tij. Disa djem në sallë ngritën dorën për të replikuar, por askujt nuk iu dha mundësia të fliste”, tregoi aktorja.

Sipas saj, në fund të takimit ajo i kërkoi Ramës të lejonte përfaqësuesit të shpreheshin. “Kur mbledhja po shkonte drejt fundit, i thashë: ‘A mund të flasim, a do na dëgjoni?’. Ai më tha: ‘Dil jashtë’. Unë i thashë: ‘Po mo, dal edhe jashtë’, por ne kishim ardhur sepse na ishte thënë se kryeministri do të dëgjonte zërin tonë.

I thashë: ‘Dil jashtë, të lutem’. Ai m’u përgjigj: ‘Jo, mos m’u drejto kështu’”, deklaroi Ceno.

Ajo shtoi se Rama u ngrit i irrituar dhe urdhëroi ndërprerjen e takimit deri në largimin e saj nga sala. “U çua shumë i irrituar dhe tha: ‘Ndërpritet mbledhja derisa të dali zonja jashtë’. Në atë çast, i gjithë komuniteti u bashkua me mua dhe dolëm të gjithë jashtë.

Nga ana jonë nuk pati asnjë provokim. Unë thjesht kërkova që të na dëgjonte dhe të na lejonte të flisnim”, u shpreh Egla Ceno.

të fundit /



Sistemi “Qytet i Sigurt” nis funksionimin në Veles



LSDM: TVSH-ja për karburantet duhet të ulet në pesë përqind,...



Formacionet zyrtare të derbit Manchester United-Manchester...



Donika Gërvalla: Qeveria Kurti IV nis punën me angazhim t...



Arsenali vë në shënjestër talentin e Liverpoolit, shqetësi...



Pacolli padit Shqipërinë në Arbitrazh: Aeroporti i Vlorës po merret për...



Laçi dhe Villaznia përballen në derbin e veriut, të dyja në kërk...



ARTIKULL JOETIK?

Esim for Global | Esim for Europe | Esim for Caribbean | Esim for USA | Esim for Italy | Esim for Spain | Esim for Turkey | Esim for Germany | Esim for Greece | Esim for Asia | Esim for World Cup 2026 | Esim for Saudi Arabia | Esim for Egypt | Esim for United Arab Emirates | Esim for Balkans | Esim for Morocco | Esim for China | Esim for United Kingdom | Esim for Africa | Esim for Latin America | Esim for GCC Gulf Cooperation Council | Esim for Middle East | Esim for South America | Esim for Canada | Esim for Mexico | Esim for Japan | Esim for Albania | Esim for Kosovo | Esim for Switzerland | Esim for Tunisia | Esim for South Africa | Esim for Algeria | Esim for Portugal | Esim for Brazil | Esim for Argentina | Esim for Colombia | Esim for Hong Kong | Esim for Thailand | Esim for Macau | Esim for Malaysia | Esim for Vietnam | Esim for South Korea | Esim for Austria | Esim for Netherlands | Esim for Australia | Esim for Russia | Esim for India | Esim for Chile | Esim for Peru | Esim for Poland | Esim for North Macedonia | Esim for Sweden | Esim for Finland | Esim for Norway | Esim for Belgium

Shtuar më 13.09.2026 16:40



Pacolli padit Shqipërinë në Arbitrazh: Aeroporti i Vlorës po merret për t'iu dhënë...



Rama hap 4 Universitete, Shkodra mbetet jashtë/ Boçi: Hakmarrje politike



"PISA 2025"/ BIRN: Pasqyra e deformuar e suksesit të qeverisë me...



FOTOT/ Alessio Aliaj zhvendoset në Tiranë, nis bashkëjetesën me Jonida...



Debati për pagat e magjistratëve/ Rama: Një gjyqtar fillestar në Shqipë...



Rikthehet Celine Dion, performon live përballë fansave në Paris pas më...



Protesta hyn në ditën e 106-të, diaspora rikthehet në shesh dhe kërkon...



Rusia e gatshme për negociata, por pa armëpushim, Lavrov: Në...



© 2003 - Albeu Online Media. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kërko

Kryesore

Erion Veliaj
Free Esim
Zgjedhjet 2025
Belinda Balluku
SPAK
Kombëtarja

Kategori

Lifestyle
Showbiz
Tech
Shëndetësi
Argetim
Enciklopedi

Linqet

Live tv shqiptare
Moti në Shqipëri
Travel
Horoskopi
Livescore
News from Albania

Tags

Edi Rama
Albania News
Ilir Meta
Piranjat
gazeta, tv, portale
Sali Berisha

Moti

Moti në Tiranë
Moti në Prishtinë
Moti në Shkup
Moti në Durrës
Moti në Prizren
Moti në Tetovë

© 2003 - Të gjitha të drejtat janë të rezervuara!

Kontaktimi | Kushtet e Përdorimit | Privacy Policy | Powered by: orihost.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.